



**Kolegji AAB**

**KOLEGJI AAB**  
**FAKULTETI I INFERMIERISË**  
PROGRAMI (BSc) Infermieri e Përgjithshme

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË STUDENTËVE PËR PUNËN  
LABORATORIKE**

**Zyra e Sigurimit të Cilësisë**  
**Nëntor, 2022**

Krahas ligjëratave dhe orëve teorike, plan programi i studimit BSc Infermieri i Fakultetit të Infermierisë përmban orë praktike të cilat janë obligative të përfundohen nga studentët. Varësisht nga viti i studimeve, praktika e studentëve realizohet në ambientet e AAB-së, përkatësisht laboratorë, si dhe në qendrat e mjekësisë familjare, në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, spitalet regionale etj.

Me qëllim të identifikimit të mangësive potenciale dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së punës praktike, Zyra e Sigurimit të Cilësisë ka realizuar pyetësor me student lidhur me praktikën e mbajtura në laboratorët e AAB-së të zhvilluara në kuadër të plan programit të studimit.

**Tabela 1. Pyetje lidhur me punën praktike në laborator**

Nr.	Pyetja	Nuk pajtohem	Neutral	Pajtohem
1	A keni përfituar shkathtësi të mjaftueshme për procedurat infermiore gjatë mbajtjes së praktikës në laborator?	1.36%	14.09%	84.55%
2	A ka pasur asistenti njohuri të mjaftueshme për simulimin e shkathtësive praktike në laborator?	3.18%	5.45%	91.36%
3	A keni arritur të praktikoni dhe të përvetësoni shkathtësitë e demonstruara nga asistenti?	2.27%	10.91%	86.82%

Në tabelën më sipër është paraqitur një përmbledhje e rezultateve lidhur me pyetjet për praktikën e zhvilluar në laborator të AAB-së. Sipas përgjigjeve të studentëve, pjesa më e madhe e tyre (84.55%) pajtohen se gjatë mbajtjes së praktikës në laborator ata kanë përfituar shkathtësi të mjaftueshme për procedurat infermiore. Studentëve u është parashtruar edhe pyetja në lidhje me njohuritë e asistentëve për simulimin e shkathtësive laboratorike, dhe në bazë të përgjigjeve, 91.36% e studentëve janë pajtuar që asistentët kanë pasur njohuri të mjaftueshme për procedurat e tilla. Nga praktika e realizuar, 86.82% e studentëve janë pajtuar se kanë arritur të praktikojnë dhe të përvetësojnë shkathtësitë të cilat janë demonstruar nga ana e asistentëve. Në bazë të këtyre rezultateve, në tri pyetjet më lartë, ne mund të përfundojmë se asistentët kanë pasur njohuri të mjaftueshme për simulimin e shkathtësive praktike dhe se studentët ndjehen se kanë arritur të përvetësojnë punën laboratorike në mënyrë të mjaftueshme.

**Figura 1. Mjetet e punës në laborator**





Figura më sipër, paraqet rezultatet e pyetjes “A i keni pasur në dispozicion të gjitha mjetet e nevojshme për implementimin e teorive të të mësuarit në praktikë?”. Në këtë pyetje, janë përgjigjur gjithsej 220 studentë, dhe rreth 55% prej tyre pajtohen se i kanë pasur mjetet e nevojshme në dispozicion. 35% prej tyre kanë shprehur qëndrim neutral dhe vetëm 10% e studentëve mendojnë se ka pasur mungesë të pajisjeve implementimin e teorive të të mësuarit në praktikë.

**Figura 2. Gatishmëria e asistentit për sqarime shtesë**



Në pyetjen “A ka qenë i gatshëm asistenti të jap sqarime shtesë në rast të paqartësive”, rreth 95% nga 220 studentët e anketuar pohojnë se asistenti ka qenë i gatshëm për të dhënë sqarime shtesë në rastet kur ata kanë pasur paqartësi me procedurat e aplikuara në laborator.

**Tabela 2. Komentet e studentëve për praktikën (për qëllime të raportit, komentet janë përmirësuar në aspektin gramatikor)**

Komente
Unë si studente jam shumë e kënaqur me praktikën që ne bëjmë dhe janë shumë të kuptueshme
Nuk ka pajisje të mjaftueshme!
Nuk kam asnjë vërejtje, deri tani gjithçka ka qenë në rregull!
Unë jam i kënaqur me orën e praktikës laboratorike, të vazhdojmë kështu.
Gjithçka në rregull është për momentin
Gjithçka është në rregull për momentin, nuk kam sugjerime
Pajisjet esenciale si dorezat, faculetat dhe mantelet është e nevojshme që të jenë në laborator për realizimin e punës praktike
Mendoj që ka nevojë për disa mjete të cilat janë në mungesë në laborator
Unë sugjeroj që të ketë modele të neonatev (të porsalindurve) pasi që në orën e fundit ato kanë munguar gjatë praktikës dhe është dashur të improvizojmë për ta kuptuar mënyrën e mbajtjes, larjes dhe ushqyerjes së tyre.
Jam shumë e kënaqur me praktikën në laborator por vetëm që ka mungesë të disa mjeteve të punës të cilat na vështirësojnë punën praktike.
Të kemi mundësi që ta bëjmë praktikën të gjithë studentët pasi që nuk na premtan koha
Është shumë në rregull, po ashtu gjatë praktikës kalojmë shumë mirë dhe mundohemi si praktikant të vitit të parë me u bo prej shkathtësive më të mira
Duhet të ketë më shumë pajisje dhe mundësisht funksionale si dhe mantelet t’i kemi
Mendoj që deri tani nuk ka vend për të shtuar diçka rreth praktikës; për momentin çdo gjë është duke ecur mjaft mirë
Unë si studente e Kolegjit AAB jam shumë e kënaqur mu punën që bënë asistenti jonë gjatë praktikës
Përveç disa gjërave që na kanë munguar në laborator, gjithçka ishte në rregull, si shpjegimi ashtu edhe ilustrimi i asistentit. Pra, nuk ka qenë e nevojshme të shpjegohen dy herë të njëjtat gjëra pasi që kanë qenë të qarta.
Në një rast në praktikë ka qenë pastrimi i pacientit edhe ushqyerja e kukullës të bebes; nuk kemi arritur të bëjmë veshjen, pastrimin, ushqyerjen edhe pse profesoresha e ka kërkuar në laboratorët tjerë, askund nuk e kemi gjetur kukullën, gjithashtu ka pasur mungesë edhe të disa gjërave tjera
Nuk kam ndonjë sugjerim, më pëlqen ashtu si është.

## **PËRMBLEDHJE DHE REKOMANDIME**

Ky raport është hartuar në bazë të rezultateve të vlerësimit të studentëve për punën praktike që kanë kryer në laboratorët e AAB-së. Në bazë të përgjigjeve nga pyetësi, rezultoi që puna praktike është realizuar me sukses dhe se studentët janë deklaruar që njohuritë e fituara gjatë ligjëratave janë zbatuar në praktikë.

Asistentët të cilët kanë mbajtur punën praktike, sipas vlerësimit të studentëve, kanë pasur njohuri të mjaftueshme dhe janë munduar që t'i stimulojnë studentët për përfitimin e shkathtësive infermierore. Puna e asistentëve vlerësohet mjaft lartë edhe sa i përket ofrimit të sqarimeve në rastet kur studentët kanë pasur paqartësi. Rreth 95% e studentëve pohojnë se asistentët kanë qenë çdo herë të gatshëm të japin sqarimet e nevojshme. Pra, sa i përket punës së asistentëve në laborator, studentët thuajse të gjithë janë të kënaqur, si nga vlerësimet në bazë të alternative për përgjigje ashtu edhe nga komentet e lira të cilat pohojnë se shpjegimi dhe mënyrat e demonstrimit të punës praktike nga asistentët kanë qenë mjaft të qarta.

Në bazë të vlerësimeve në pyetjen e parashtruar rreth mjeteve në laborator, si dhe në bazë të komenteve të hapura nga studentëve, vërejmë se një pjesë e konsiderueshme e studentëve mendojnë që laboratorët kanë mungesë të pajisjeve për të zhvilluar apo praktikuar të gjitha ushtrimet. Rrjedhimisht, sugjerimet kryesore për përmirësim nga vetë studentët si dhe nga Zyra e Sigurimit të Cilësisë janë:

- Të avancohen tutje mjetet e punës në laborator dhe të jenë në hap me trendët e zhvillimit të infermierisë në vendet evropiane
- Të konsiderohet mundësia e praktikave më të specializuara sipas kërkesës dhe nevojave individuale të studentëve
- Të konsiderohet zgjerimi edhe më tepër i mundësive të bashkëpunimit me spitale të tjera private ku studentët mund të kenë një gamë më të gjerë zgjedhjeje për vijimin e praktikës.